

VENDIM
Nr.723, datë 14.5.2008

PËR PËRBËRJEN E KOMITETIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE
SHPIRTËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore të kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe në përbërje të ketë:

- | | |
|---|-----------|
| - drejtorin e drejtorisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore | sekretar; |
| - përgjegjës in e sektorit për trashëgiminë shpirtërore, | anëtar; |
| - një specialist për trashëgiminë shpirtërore | |
| pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore | anëtar; |
| - drejtorin e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Kulturore | anëtar; |
| - drejtorin e departamentit të kulturës popullore në Qendrën Kombëtare të Albanologjisë | anëtar; |
| - një specialist të departamentit të kulturës popullore në Qendrën Kombëtare të Albanologjisë | anëtar; |
| - drejtorin artistik të ansamblit të këngëve dhe valleve popullore | anëtar; |
| - sekretarin e Komitetit Kombëtar të UNESCO-s | |
| pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme | anëtar. |

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha